

## INTERVISTË ME MEHMET KRAJA

Prishtinë | Data: 4 nëntor 2014

Kohëzgjatja: 130 minuta

Të pranishëm:

1. Mehmet Kraja (I intervistuari)
2. Jeta Rexha (Intervistuesja)
3. Kaltrina Krasniqi (Intervistuesja/Kamera)

*Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:*

() - komunikim emocional

{ } - e intervistuar shpjegon me gjeste

*Simbole të tjera në transkriptë:*

[ ] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

*Fusnotat janë shtesa editoriale të japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.*

## Fëmijëria

*[Pjesë e prerë nga video-intervista: intervistuesja e pyet të intervistuarin për fëmijërinë e tij.]*

**Mehmet Kraja:** Unë kam lindë... fëmininë e kam kalu deri në moshën 15 vjeçare në Krajë, dhe janë fshatra afër liqenit t'Shkodrës. Ka qenë një fëmini pothuajse e ngjashme me fëmininë e njerëzve gjeneratës sime, fëmini e vështirë me shumë dëshira dhe me pak mundësi. Vendi ku jam rritë unë ka qenë një vend pak specifik, është një zonë kufitare dhe pranë liqenit t'Shkodrës. Ka një shpërpjesëtim brenda. Është hapsinë shumë e bukur, shumë e kandshme por jetohet shumë vështirë. Ky shpërpjesëtim i brendshëm ndoshta m'ka ndjekë tanë jetën sepse vazhdimisht e kam pasë këtë kundërshti brenda në mes asaj që është ideale dhe asaj që... edhe pamundësisë t'njeriut për ta arritë ate. Është një gja që me kohë, ajo bahet pjesë e karakterit t'njeriut.

Megjithatë, nga ajo periudhë maj n'mend gjana interesante, disa gjana janë... kufizohen me realizmin magjik do ta quajsha unë sepse jam letrar dhe andej m'shkon mendja. Janë gjana që marrin dimenzion gati fantastik domethanë. Njerëzit aty kanë jetu në një botë relativisht... jashtëzakonisht t'mbyllur. Ne kemi pasë përballë Shkodrën të cilën nuk kemi shku kurrë edhe t'cilën e kemi shiku gjithmonë nga ato naltësitë tona, dhe t'cilën njerëzit tanë e kanë andru, por s'kanë pas t'drejtë ta shijojnë. Ajo pastaj, me kohë merr... ai kufi që i ka nda zonat tona me Shqipërinë diku fillon merr përmasa mitike dhe ndonjëherë, merr përmasa t'çuditshme të një fantagozmërie.

Di vetëm një gja që në kushërinë ynë plak ka qenë, e maj n'mend shumë mirë – Selimi. Ai mendonte që dielli dilte nga një vrimë n'Maranaj. Maranaj janë male mi Shkodrën edhe përfundon dhe futet në një vrimë tjetër pas Rrumnise, edhe kjo është bota, s'ka tjetër, kaq është bota. Nëse ishte mbyllur rruga për Shkodër, kurrë s'kishte dalë prej katunit, s'kishte shku kurrë kërrkun n'jetë t'vetë. Këta njerëz kishin në mendjet e tyre, kishin Shkodrën dhe asgja ma shumë se kaq. Në shumë vështirësi u integrun', shumë vonë fillun të integroheshin në ato hapësirat kur realisht, politikisht i nxorri historia që të jetojnë. Është një vend ku ka lëvizë kufini dhe kufini ka qenë një mallkim dhe njëkohësisht ka qenë një legjendë... për të janë thurë edhe legjenda, ka qenë një mit.

Unë e maj n'mend diverzantët që kalonin andej kufin, kalonin në të dyja... veçmas ata që vinin nga Shqipëria, kërsitshin rrugën natën kur kërsitke automatiku, ishte fëminija e hershme kur marrëdhانيت shumë t'vështira me Shqipërinë e kur të dyja palët janë diverzante kundër njani-tjetrit. Kaniher' m'duket sikur kjo ka ndodhë para një mijë vjetësh, por realisht nuk është, nuk janë një mijë vjet janë pak më shumë se... mund të jetë 50 vjet, por jo më shumë se 50-60 vjet. Domethanë, këto janë ndodhi reale të cilat unë i mbaj n'mend nga fëminija.

Pra, është një fëmini e tillë domethanë... që pastaj ai vend ka jetu në një, shpesh në një, është shpërba në një tragjedi që shkaktojnë idetë e mëdha. Idetë e mëdha kur përthyhen në vende t'vogla të shkaktojnë tragjedi. Komunizmi, fashizmi... pra kur vijnë në vendet e vogla shkaktojnë edhe rrëmujë t'madhe, shkaktojnë telashe t'madhe.

Nji mësues në kurs ishte, në mledhje socialiste... bante mledhjet e katundit, ai fliste herë pas here nëpër mledhje dhe kishte frikë mos t'gabojë dikun. Edhe kur... për ta qetësu disi situatën edhe për t'kriju favore për veten, hypte me të dyja kambët mbi karrigë e thërriste me zo t'naltë "Rrnoftë komunizmi!" ose "Rrnoftë socializmi!" Do t'thotë kjo ishte situata kur e shihte mos ka gabu në noj gja, për me mujtë me i përforcu pozitata e veta.

Këto janë situatat i kam kalu deri në kohën e gjimnazit. Në gjimnaz pastaj kam shku në Ulqin. Për me shku në Ulqin banin, zakonisht i kalonim n'filim, ose duhej me shku përmes liqenit në anije për t'dalë në Novi Pazar, pastaj me tren me dalë n'Tivar e pastaj me autobus, ishte një rrugë gjithë ditën zgjaste. Veçmas dimrit kur ishte borë ose kalonim përtej maleve dhe shkonim n'Ulqin, kishim nja katër orë e gjysë n'kamë dhe pastaj duhej me shku edhe me autobus pak edhe kështu mrrinin n'Ulqin.

N'Ulqin, kam kalu katër vjet të rinisë së hershme. Kryesisht janë vitet sikur të gjithë të rinjtë, quhen vitet e andrrave, vitet e ëndërrimit janë ato. Për herë t'parë përballet njeri me një ndjesi t'çuditshme, një pafundësi siç është deti. Deti është një metaforë shumë e çuditshme, me t'cilën kur e sheh për herë t'parë të le të stepun dhe nuk ke fjalë ta spjegosh edhe dukesh shumë i vogël përballë tij, domethanë këtë ndjenjë e kisha. Pastaj, fillon e mëson historitë e ndryshme për atë vend dhe ato histori janë... ndonjëherë të duket sikur i sheh ato që i lexon nëpër libra – ato kalorës, ato beteja, ato lufta mesjetare. Sikur, po i mbylle pak sytë ato shfaqen njëherazi sepse është kalaja edhe Ulqini n'atë kohë ka pas pak banorë, ka qenë një qytezë me pak banorë.

Kjo është ana idealiste, ku unë po e idealizoj Ulqinin, në anën tjetër ka pasë një problem shumë serioz në Ulqin. Ka qenë një problem politik, Ulqini ishte një qytet shqiptar por që fliste dhe msonte serbisht. Ne ishim nga fshatrat dhe vinim aty të bënim shkollë shqip. U hap gjimnazi, gjimnazi nuk kishte asnjë nxanës nga Ulqini në shqip, të gjithë ishin në serbisht, serbo-kroatisht që i thonin atëherë. E kjo ishte situatë shumë e randë, deri ka fundi i gjimnazit për ato katër vjet, nuk pat asnjë nxanës që erdh në paralelet shqipe. Pastaj, u hapën... filluan pak më ndryshe... u kriju' një klimë pak ma ndryshe. Ishte një klimë e randë politike, kjo është dikur në '67-'71. Fryma që filloi n'Kosovë pra me u ndi edhe atje. Fryma filloi n'Kosovë me lëvizjet e '68-tës, që në '66-tën.

Më kujtohet në '68-tën mos gabofsha, ka qenë mas demonstratave n'Prishtinë u dëgju jehona e tyne me organizim t'vogël. Por, e di një gja që kryetari i komunës kishte qenë drejtor i gjimnazit, paraprkishtë mbajti një mbledhje në t'cilën ai tha decidivisht që flamuri i shqiptarëve do t'ngritet në institucione paralelisht flamurit jugosllav, të Malit të Zi etj. Domethanë, ne e përkthym kështu, se ishim shumë t'ri, që kto nguteshin ta vendosnin para se ne t'kishim nevojë ta nxerrnim me dhunë ose me njëfarë... na e morrën argumentin, thjesht na e morrën nga dora dhe na nxorrën jashtë.

Kjo ishte një pëpjekje për të kriju një identitet dhe realisht t'fillojë pak një klimë tjetër, pak ma ndryshe të funksionojë Ulqini. Edhe krejt ajo pjesë e shqiptarëve të Malit të Zi kem pas trysni të ndryshme. Ka qenë shumë vështirë në gjimnaz. Gjimnazi ka qenë me punu n'shqip, gjuhën, msimin e ka pas shqipen dhe shumicën e landëve e kemi pas serbisht, mungesë kuadri, trysni, vazhdimisht presione, pandërpre shkollën. Na vinin profesorat të ndryshëm jo vetëm emigrantë nga Shqipëria, jo të tjerë që ishin shumë të papërshtatshëm, pra gjithnji kishim një trysni nuk vinte drejtpërdrejtë pushteti, u legalizu. Por, vinte nga lëvizjet të cilat ishin më klandestine, pranë sistemit edhe vetë brenda vetë shtetit. Kjo ka zgjatë deri në 1971. Në '71 kam ardhë n'Prishtinë, këtë Prishtinë që po e shihni {bën me kokë nga dritarja}. Bile kjo ktu {tregon me gisht} kjo ish-shkolla e naltë e Pedagogjike që shihet këtu, ka qenë edhe atëhere, kjo rrugë ka qenë në baltë. Kjo lagje ka qenë në ndërtim e sipër, ky Aktashi i sipërm e kujtoj shumë mirë. Ka pas një

teatër e maj n'mend shumë mirë. Restorant Unioni që ka qenë aty, midis Teatrit dhe Unionit kalonte një përrockë e qelbur.

Prishtina ka marrë strukturë urbane... këta që e majnë n'mend, që janë ma t'vjetër se une dhe që janë prishtinali i dijnë shumë mirë. Me kryetarin e Komunës Nazmi Mustafa, plakun i thonë, ashtu e kanë qujtë se u kanë i tillë. Ai plaku, këtë strukturë urbane që e ka, ashtu siç e ka, këto rrugë kryesore që i ka, i ka marrë kur i bjen në '73 në '74 mund t'jetë... po aty midis '71-'74 gjatë kohës kur isha student, domethanë ka marrë këtë formë, këtë strukturë. Atëhere ka qenë periudha e autonomisë së plotë të Kosovës, ka qenë edhe periudha e ndërtimit të institucioneve, ku di une... Radio Prishtina, Pallati i Shtypit.. ku di une këto ndërtesat e fakulltetit edhe janë ba... Të gjitha strukurat e institucioneve që i kemi na sot, edhe ato shtetnore edhe të tjerat edhe institucionet kulturore edhe administrative kryesisht janë ndërtu në qat kohë domethanë në periudhën e autonomisë. E pastaj ashtu ka vazhdu ajo... deri në ditët e sotme.

## Rinia

*[Pjesë e prerë nga video-intervista: intervistuesja e pyet të intervistuarin për rininë e tij.]*

**Mehmet Kraja:** Studimet i kam kry në Letërsi, bile nuk di... kam një gja t'pakandshme, kur i kam thanë profesorit në një gjimnaz, n'gjimnazt t'Ulqinit se du me studiu letërsinë, jonë nalë pak... se kom qenë nxanës i mirë, kom pas nota t'mira edhe në shkenca ekzakte domethanë fizikë, matematikë... "Si, si letërsinë?" "Qe, kështu mu ka tekë". Nuk ja ka marrë menja kërkujt, zakonisht në letërsi, zakonisht shkojnë nxanësit e dobët, ose nxanësit mesatarë, ose të shkencave shoqërreth gjuërore... e kemi njiifar... nxanësi i mirë duhet me shku në shkenca ekzakte edhe u kry ajo punë, dihej! Kështu që, unë shkova në Letërsi.

Kam fillu' me punu pa i kry studimet. Një herë kam qenë kryeredaktor i Botës së Re dhe në t'njejtën kohë jam pran gazetar i... Bota e Re, ka qenë gazetë e studentëve. Kom qenë kryeredaktor i Botës së Re në '74-'76, dy vjet. Pastaj, m'kanë qitë. M'kanë qitë ata që sot janë njerëz t'rëndësishëm t'politikës. Me thanë që bile, bile kishte thoshin se mos do të na shtijnë n'burg si redaksi krejt, po pshtum prej burgut, po me na qitë, na qitën me shpejtësi. Ka qenë një kohë e liberalizmit në Kosovë. Duhet ta pranojmë këtë situatë. Por, në anën tjetër, në pikëpamje politike, gjanat kontrolloheshin me shumë kujdes dhe bahej një luftë e ashpër, midis rrymave brenda vetë pushtetit. Domethanë me një anë pushteti jepte mundësi dhe aktronte më shumë liberalizmin, n'anën tjetër përmes ideologjisë, përmes formave partiake, përmes organizimit partiak i shtrëngonte anët ideologjike. Ne ishim njihkohësist edhe njerëz t'lrirë por edhe t'robërum paralelisht. Ishte një paradoks, po kështu ishte.

Në raport me të tjerët, me vendet tjera socialiste, ishte edhe ktu Kosova ishte... Jugosllavia e asaj kohe avanconte në pikëpamje t'lrisë. Kjo ishte në pamje t'jashtme. Në anën tjetër, shteti, partia, organet e sigurimit, kishin kriju një agjenturë perfekte e cila funksiononte deri në qelizat ma t'thella edhe ma t'largta të shoqnisë, e kontrollonte çdo gja. Natyrisht kontrolli nuk ka qenë ideologjik, aq sa ka qenë megjithëse këtu kishte gjithmonë një problem. Kishte një lidhje midis, ata gjithmonë konsideronin se ekziston një lidhje mes nacionalizmit dhe dogmatizmit. Pra, dogmatizmi dhe nacionalizmi janë afër sepse e kishin modelin e Shqipërisë. Ktu lufta bahej që modeli i Shqipërisë, i ideologjisë t'Shqipërisë t'mos kalonte n'kit anë.

Ajo periudhë ka qenë periudhë... megjithatë ka qenë periudhë e liberalizmit do ta quaja unë. E tash na si studentë kishim pak një frymë t'tillë që donim pak më shumë se ç'na jipnin edhe bonim atë botën e re,

bonim ndonji për atë kohë ndonji skandal t'vogël. Dhe atëherë, kryetari i rinisë vrap na merrte përpara, vinte në mledhje me ndonji asistent... jonë ba t'rëndësishëm tash, janë njerëz t'randësishëm. Kur fiket kamera ju përmendi me emra e tani e shihni qartë që janë përnime janë njerëz tepër t'rëndësishëm, nuk do t'i përmendi emrat. Natyrisht u ba një grup punues edhe në... redakisa e Botës së Re ka qenë te menza e studentëve, edhe... na shkarkun të gjithëve, edhe për mu thanë, "Ai osht' n'Rilindje, mos t'bon za, le t'rrin n'Rilindje". Se për tjerët ishte problem se ça do t'bahet me neve.

Rektori i Universitetit ka qenë profesor Idriz Ajeti t'cilin unë e kom tash në Akademi. Ai na ka mbrojtë. Na ka mbrojtë... nuk besoj që e ka lexu ndonjëherë Botën e Re se merrej me punë tjera por na ka mbrojtë, edhe na ka mbrojtë seriozisht. Kështu s'paku më kanë thonë atëhere që na ka mbrojtë.

## Gjuha

Këtu tash ka një... rreth gjuhës duhet t'qartësojmë disa gjana. Raportet e Kosovës me gjuhën letrare janë pak ma specifike dhe shpesh po krijohen disa t'i quaj kështu... po krijohen do ide që nuk janë do paraftyrime jo shumë t'qarta për atë kohë dhe për ato zhvillime. Nëse e themi se n'kulturë u përpoq t'krijohej një komb në vete, t'boj një komb në vete, domethonë e thanë këtë edhe mas '81-shit. Mas '81-shit u nxorrën të gjitha të palarat e sistemit, dolën n'sipërfaqe. Krejt projektet që ishin ba me shqiptarët dolën, se nuk i mbanin dot ma sepse dolën në terren t'hapun çdo gjë doli n'terren t'hapun.

Atëhere nëse ktu u synu që t'bahej një kulturë ndryshe, nëse u synu që kjo t'bahej, t'krijohej një identitet shqiptar i intergrum n'Jugosllavi... është krejt normale që kishte pas qëllime që gjuha jonë n'pikëpamje gjuhësore të bahet diçka, t'preket diçka. Është llogjike nëse është ba diçka n'fushën e letërsisë, në qoftëse është ba diçka në fushën e artit figurativ, është ba n'muzikë, është ba në politikë, është ba në jetën shoqërore, normalisht që do t'duhej, diçka është synuar të bahet edhe në gjuhë. Ka historinë e vetë ky zhvillim n'gjuhë. Ka një periudhë kohe kur diku ka fundi i viteve '50, ka mesi i viteve '50 kur hapet Instituti Albanologjik, mbahet dy vjet, mbyllet, bihet Selman Riza, vehet aty me tre-katër studiues të bohet Selman Riza.

Fillon periudha tjetër e errët – rihapet Instituti Albanologjik, sepse lidhen kto gjana me institucione. Hapet edhe fakulltet, veç te instituti e kam fjalën... bëhet ma vonë në '63-shin, ka një lëvizje e cila çon, herë Kosova duhet të marrë variantin letrar, ose variantin e gegërishtes, herën tjetër të marrë variantin letrar që ka adoptu Shqipëria. Krejt kto bahen lëvizje deri në '78-tën, që jonë lëvizje simas politikave që zhvillohen n'atë kohë. Në '68-shin konsullta gjuhësore e Prishtinës e mbyllë këtë problem. E mbyllë sepse merret një vendim i mbështetur politikisht që shqiptarët në Jugosllavi do t'shkrujnë gjuhën e cila shkruhet n'Shqipni. Natyrisht me diferencat e mundshme t'nevojshme, sepse ende s'kishte një drejtëshkrim të saktësum, as vetë Shqipëria, me diferencat e lejume që mund t'funksiononin edhe ma tutje.

Ta themi një gja të saktë. Tani vjen Kongresi i Drejtëshkrimit. Në '72-shin bahet Kongresi i Drejtëshkrimit, në librin e Fadil Hoxhës, si e ka titullin... e gjeni titullin {i referohet intervistueseve} se nuk m'kujtohet momentalisht. Librin e Fadil Hoxhës shkrun saktësisht, "Lehen për t'marrë pjesë kosovarët në Kongresin e Drejtëshkrimit" e dha Petar Stambolić, njeriu numër një në Serbi, jo në Jugosllavi, në Serbi. Politikani numër një në Serbi. Çka ndryshoi, pse u ba kjo kështu? Pse në Jugosllavi kjo frymë domethanë që t'integrohen se ishte gjuha të jipet mundësia që shqiptarëve në Jugosllavi që ishim, kombi i tretë u bonëm. Shqiptarët në Jugosllavi u bonëm kombi i tretë numerikisht, mas kroatëve, ma shumë se maqedonët, ma shumë se sllovenët, ma shumë se boshnjakët numerikisht kishte pak, sapo filloi diferencimi i tyre, pra ishte kombi i tretë në Jugosllavi. Pra, pse tani tyne përnihet ju lejohet? Qikjo ka t'bëjë me liberalizmin që e përmenda gjatë viteve t'70-ta, por ka fryma liberale që depërton, edhe në parti edhe n'shtet edhe krejt, por ka edhe një strategji. Strategjia është se Jugosllavia heqë dorë në atë kohë

nga pamja e një kombi t'Veçantë nga shqiptarët e Jugosllavisë. E sheh që asht' e pamundun t'bahet mo një komb i veçantë. Dhe, prandaj do shqiptarët në Jugosllavi do t'trajtohen si pakicë kombëtare.

Në një anë kjo kishte disfavoret e veta, sepse po t'ishe komb do t'kishe do favore se ishte pjesë konstituive e shtetit jugosllav. Se kombet i kishin, vetëm ato pesë kombet që i kishin t'drejtën për t'qenë element konstituiv, republikat, gjashtë republikat. Kombësitë nuk kishin të drejtë të ishin element konstituiv, kishin vetëm anekse. Tani u hoq dorë përfundimisht nga kjo, u hoq dorë edhe iu dha mundësia shqiptarëve që të komunikojnë në nivel të... domethënë gjuhën e shkrimit ta kenë t'njejtë që të mund të komunikojnë në mënyrë të papenguar me kulturën. A ta quajmë, kështu kultura A, është pak e papërshtatshme ta quajmë. Megjithatë, kështu është!

Tani thonë që ku e di unë, kjo është produkt komunist. Se komunistët e të dy anëve kanë vendosë me e bo gjuhën kështu, se kështu kjo gjuhë nuk asht dashtë, por nuk kishte potencial Kosova të bante gjuhë në vete. Me çka do e bante, si do e bante? Nji gazetë dhe do libra me nji traditë shkrimi... mos harroni '44, '45-shin, Kosova del me një masë ta jashtëzakonshme të analfabetëve. Mbi nëntëdhjetë përqind e popullsisë është analfabet, dhe tani për një periudhë ta zamë njëzet-tridhjetë vjeçare, çka do t'bante? Do t'bante letërsi, do t'bante kulturë dhe do t'bante gjuhë në vete. Punë që s'bahet! Edhe po e bante gegnishten, përsëri e merrte variantin e Shkodrës - shkodranishtën. Nuk e bante dot vetë sepse s'kishte traditë shkrimi, pse s'kishte traditë shkrimi është tani prapë ndryshe, që duhet me e shiku dhe studiu, por problemi është që nuk kishte letërsi, nuk kishte traditë shkrimi edhe nuk kishte traditë të kultivimit t'gjuhës. Dhe, për pasojë, ishte krejt normale që t'merrej... nuk është pse e morre, se ata ishin komunistë, se andej komunizmi... Jo, ma së paku kishte t'bente me k'të. Kishte t'bante me nevojën për t'komuniku kulturat mes veti. Sepse fundi, gjuha është një kod, gjuha është marrëveshje, gjuha letrare është marrëveshje.

Gjuha standarde është marrëveshje! Ne merremi vesh që t'shkrujmë kështu sepse komunikojmë ma mirë. Kaq është, asgjë ma shumë se kaq. Ne komunikojmë nëse du'm t'komunikojmë me lagjen e Prishtinës, shkrujmë n'gjuhën e lagjes s'Prishtinës. Nëse du me komuniku me Prishtinë deri n'Llap e pak deri n'Drenicë, shkrujmë me këtë gjuhë. Nëse du me komuniku nji hap ma tej, duhet t'shkrush me gjuhën t'cilën munen me komuniku njerëzit në nji hapsinë ma t'gjanë.

## Lufta

*[Pjesë e prerë nga video-intervista: intervistuesja e pyet të intervistuarin për kohën e luftës]*

**Mehmet Kraja:** Sot është paraqitë nevoja, n'shekullin njëzet, është paraqitë qysh n'shekullin 19 nevoja e integritit brenda hapsinave kombëtare; dhe gjuhët jonë konsolidu qysh në shekullin 19. Ne ishim vonu dhe erdhëm n'shekullin njëzet, n'gjysmën e dytë t'shekullit njëzet, erdhëm me nji diversitet gjuhësor; dhe u pa nevoja që kjo duhet të bahej siç bahen kombet e kulturura t'i kthejnë në gjuhë, të komunikojnë me një gjuhë standarde. Pra, të bajmë një marrëveshje se gjuha është marrëveshje, standardi është marrëveshje; të bëjmë një kod gjuhësor, një kod komunikimi me t'cilin ne merremi vesh lehtë dhe pa probleme. Merremi vesh n'krejt hapsinën, jo vetëm mrenda lagjeve, po brenda n'krejt hapsinën, dhe kte e bamë.

Kte e bani Kongresi i Drejtshkrimit. Nuk ka asgja mistifikuese n'kte. K'to janë gjana shumë praktike domethanë. Tani vjen koha e globalizmit. Normalisht! Tani nuk mjafton ma gjuha kombëtare, e shihni ju vetë që kemi metë na ma shumë te ajo, te gjuha e jonë, te ajo jemi realitete, jemi fosilizu realisht. Kështu na konsideroni ju se jeni gjeneratë ma e re. Se jemi tashi, jo mjaft të avancum sepse globalizmi ka kërkesa



t'reja. Jo ma të getoizohemi brenda vetë kombit, kjo s'ka kuptim! Ky është idiotizëm. Ky është marrëzi. Domethanë getoizohemi brenda vetë hapsinës kombëtare. Tashi getoizimi në nivel botnor, kontemporar, global konsiderohet prapambetje, konsiderohet e jashtëkohëshme, konsiderohet marrëzi. Jo ma, getoizimi brenda një kombi. Kjo s'ka kuptim, prandaj të gjitha këto janë për kaprice kështu domethanë kaprice koti. Unë nuk them se kanë gjetë zgjidhjen ma t'mirë gjuhësore, ka mujtë njana apo tjetra t'bohët. Nuk e di, domethanë mbase ka mujtë edhe gegënishtja të futet në bazë të...

Po ja që u ba dhe nuk zhbën dot më sepse pjesa ma e madhe e shqiptarëve që pretendojnë që shkrujnë gegënishten ose që janë gegë, vetë gegë; tu përfshi edhe shkodranët e mij që i kam shumë afër, që i kam pas shumë afër gjithmonë dhe që e njoh gjuhën e tyne, ata sot për fat t'keq s'dijnë me e shkru gjuhën që vetë e kanë folë dhe e kanë shkru shumë kohë përpara sepse koha e ka ba t'veten dhe ata sot janë integru në gjuhën standarde. Deshe s'deshe ata flasin si shkodranë. Edhe kur shkrujnë, edhe kur pretendojnë që shkrujnë gegënishten, nuk e shkrujnë. E shkrujnë me gabime.

Një ide e kom pasë, që shekulli njëzet do ta mbyllë problemin e Kosovës. Si? Nuk e kam pasë idenë se si do të zhvillohen gjanat, jo me këtë shpejtësi, s'paku jo me këtë shpejtësi se na duhet t'jemi t'vetëdijshëm se kush jemi. Duhet t'jemi mirënjohës atyne që na kanë ndihmu për këtë, natyrisht edhe njerëzve tanë që janë sakrifiku. Jo me këtë shpejtësi. Une e kam pas një ide që shekulli njëzet, është shekull kur do të qartësohen gjanat n'botë. Këtë ide e kam mbajtë gjithnjë. Çuditërisht ajo u përputh me ate. Viti 2000 na gjeti realisht, na gjeti jo shtet, as jo krejt t'libër, por me një prespektivë t'qartë që se ka do t'shkojnë punët.

E tani, u bamë njerëz t'libër! U bamë vend i libër. A mjafton kjo? Kjo është dilema, tani problemi edhe shfaqja e problemit, dhe a i zgjidhë të gjitha problemet liria? Absolutisht, jo! Pritshmëria ka qenë shumë e madhe, liria nuk zgjedhë të gjitha problemet. Ajo është domosdoshmëri, është pjesë e jetës t'njeriut, nuk mund ta ndajë jetën. Liria është vetë jeta e njeriut, pa te s'mund të jetojë njeriu. Por, ajo nuk zgjidhë probleme. Nuk është instrument me t'cilin zgjidhë probleme. Disa gjana zgjidhen vetëvetiu, por jo të gjitha.

Sikundër që nuk zgjidhen as ato problemet ekzistenciale t'përbotshme, nuk i zgjidhë liria. As s'ka mujtë t'i zgjidhë asnjë formulë deri tani. Megjithatë, disa gjana u zgjidhën. Për neve, për gjeneratën time ka rëndësi jo aq, nuk flas me fjalë t'mdhaja, jetësimi i një ideali, nuk e them ate. Nuk ka t'bahjë me ate. Për mu, unë jam shumë pragmatik në këtë drejtim. Unë them që ne mund t'jetojmë në një vend ku s'paku kam një gja, një satisfaksion që n'derë nuk troket ma policia serbe dhe nuk kam frikën që dikush do të hyjë. Sepse, unë i kam përjetu' ato frika edhe ato ndjenja t'këqija. Natyrisht, kam respekt për ata që kanë vuajtë shumë ma tepër se unë dhe nuk ua ha kurrë hakun n'atë drejtim por i kemi përjetu do frika, do momente të cilat realisht ju edhe me ju thanë i keni vështirë t'i besoni. Por, kemi jetu momente shumë kritike t'jetës të cilat realisht ma nuk na përsëriten, dhe e di që nuk i përsëriten as fëmijëve tanë. Kjo si gjeneratë, ky është satisfaksion për neve. Pra, është një lliri e prekshme.

Brenga është e madhe, besoj që edhe të tjerëve të kësaj gjenerate, sepse nuk kemi ba atë që është dashtë të bënim. Pra, bamë diçka, bamë atë që është e natyrshme, se liria është pjesë e natyrshme e jetës t'njeriut, bamë atë që është utilitare, bamë atë që është ekzistenciale. Por nuk bamë atë që ishte pak ma naltë se kjo, ishte pak ma e zhvilluar se kjo. Pra, nuk bamë shtetin si duhej, nuk bamë institucionet si duhej. Nuk bamë... pra nuk e çum' proceset drejtimin që do t'duhej t'i çonim dhe kishim mundësi t'i bënim. Tani kush është...

Edhe një gja tjetër, për kte une një fajësi përballë gjeneratës së re, të cilët mund të na akuzojnë, mund të na thonë që, "Ja, ju na e prutë, na e botë një Kosovë e cila s'na duhet gja". Une përballë tyne, une nihem ndonjëherë keq përballë ksaj gjenerate. Nihem ndonjëherë keq që, realisht nuk u'a dhamë një prespektivë ma t'mirë. Po edhe kjo gjeneratë duket se tash bjen jo mbi gjeneratën tonë. Mbi gjeneratën

tonë ra nevoja, mundësia dhe nevoja e bamjes së këtij vendi, kështu siç është. Me të gjitha mrapshtitë që i ka. Duket që gjeneratës që vjen do t'i bjen hisja për me e bo Kosovën ashtu siç duan, e ashtu siç e meritojnë njerëzit ta kenë vendin e tyne.

## Aktivizmi

*[Pjesë e prerë nga video-intervista: intervistuesja e pyet të intervistuarin për periudhën e aktivizmit.]*

**Mehmet Kraja:** Ktu tashi të gjithë mendojnë që kanë jetu në një kohë historike, kohë t'randësishme të historisë, kanë bo histori, kanë marrë pjesë në histori. Une jam një prej themeluesve të Lidhjes Demokratike t'Kosovës. Bile, një libër që e kam shkru, e kam shkru i kam spjegu rrethanat në të cilën është themelu edhe Lidhja Demokratike, çfarë është gjeneza e lëvizjeve politike në vitet '90, para dhe gjatë viteve '90. Nuk konsideroj që kemi ba ndonji gja heroike mas pari, këtë duhet ta pastrojmë me veten tonë që nuk kemi asgja heroike. Bile, kemi ba një gja që intelektuale nuk ju takon të bëjnë – jemi përfshi në politikë në një kohë që klasa politike vendet e tjera edhe të ish-Jugosllavisë, e bani klasa politike.

Slllovenët, e bani klasa politike, e ndau Sllloveninë prej Jugosllavisë. Nuk pat nevojë me kriju platformë intelektuale as lëvizje intelektuale. Ishte një lëvizje ujudi e cila synonte ta mbante Jugosllavinë. Në Zagreb u formu, pastaj u përpoq të shpërndahej në krejt Jugosllavinë, edhe n'Kosovë u ba. Domethanë, u përpoq ta mbante Jugosllavinë një lëvizje intelektuale, por lëvizje intelektuale për ta konstitu shtetet e veçanta brenda ish-Jugosllavisë. Nuk pat nevojë, në shumicën e vendeve nuk pat nevojë sepse ishin vetë klasat politike, ishin vetë establishmenti politik që e ndau hisen e vetë që i takonte në Jugosllavi; ata e kishin ma t'thjeshtë situatën dhe e ndanë. Vetë politika priu ktyne lëvizjeve, vetë politikanët, klasa politike i priu ktyne lëvizjeve, në Kosovë jo.

Politika ishte e amputuar, ishte memece, ishte e sakatume, ishte... unë nuk e quj tradhtare sepse njerëzve ju thonë që kanë qenë tradhtarë, ata s'ishin, ata s'ishin asgja. Domethanë ata e kishin humbë, nuk kishim ma mundësitë... nuk u besonte, qysh n'vitet... qysh në '81-shin e mrapa, u kriju një distancë e jashtëzakonshme midis klasës politike dhe popullsisë n'anën tjetër. Dhe kjo, e pruni afër viteve '90 kur ata mo nuk e gjenin dot mo gjuhën e komunikimit me popullin e vet. Mbase edhe ata do t'donin që ta merrnin n'dorë situatën edhe t'i prinin popullit në drejtimet që i kishin pri slllovenët ose kroatët. Por, nuk kishin as atë forcë, as atë mundësi dhe ishin nën trysninë e jashtëzakonshme... mas s'e kanë pasë mendjen aty fare. Mund as të mos e kenë pasë as atë ide fare, sepse kishin formim t'tillë. Pra, ata nuk banë atë që bante klasa politike n'vendet tjera që banë.

Në Beograd u tubunë rreth Millosheviçit, klasa politike u tubu rreth Millosheviçit, edhe intelektuale sepse aty e shihte interesin kombëtar. Në Sllloveni u tubunë rreth Kuçanit rreth të tjerëve; në Maqedoni rreth Gligorovit. Të gjithë pra u afrun rreth... në Mal t'Zi rreth Bullatoviçit, Gjykanoviçit, pra gjithkush krijoi elitat politike edhe me ta shkoi përpara. Edhe intelektualët iu bashkëngjiten këtyre për t'ba një za ma shumë për t'ba punët e ecjes s'pavarësisë, pavarësimi të shteteve, krijimit të shteteve nacionale.

Ne mbetëm askund sepse shihej që Jugosllavisë po i pëlcitnin rrathët, shihej qartë ajo punë. Nuk kishe nevojë t'ishe shumë i mençur për t'pa se Jugosllavia iku, dhe tani ishte problemi, çka pas saj. Ne nuk kishim klasë politike që do t'a merrte situatën n'dorë. As s'kishte forcë, as s'kishte ide, as nuk mund t'a merrte. Ndoshta edhe s'kishte as rrethana, nuk mund t'a gjykoj bash qartë, s'paku jo tani për tani. Ndoshta, duhet një distancë kohore, një hulumtim më i mirë për me pa nëpër dokumente a ka pas edhe mundësi reale ajo. Ndoshta edhe s'ka pas mundësi reale.

Pra, edhe tani ne ç'a bamë? Ne u futëm në një lojë t'cilën nuk i takon intelegjencës. Ku i takon shkrimtarëve të bajnë lëvizje politike. Nuk është në fushën e tyre, nuk u takon atyne. Ne mund t'bëjmë



lëvizje kulturore, mund të bojme t'ndryshme tjera për lëvizje artistike, por lëvizje politike... Kjo duket pak edhe sikur edhe si ja që do të thonin edhe në Çeki kështu e kanë ata. Çekët e kanë, shkrimtarët e kanë, e bani Haveli. T'ishte disident n'Çeki ishte ndryshe nga të ishte disident në Kosovë. Na nuk kishim hallin, atje ishte disident ideologjik, edhe n'Kosovë nuk ishte situata e njëjtë. Janë situata t'ndryshme, por megjithëse ktu ndodhnin gjërat... madje mund t'thuash që pak ju paraprinë atyne. Ishim ma përpara se në Çeki, po s'ka rëndësi ajo.

Ka rëndësi fakti që ne u futëm në një lojë, u gjetëm përballë një situatë të cilën realisht Kosova mbeti në udhëkryq, mbeti pa asnjë ide se kah duhet t'shkojë. Të gjithë fillun' të ndajnë pjesët e tyre. Të gjithë fillun' të bëjnë, t'krijojnë shtetet me ide nacionale, ne mbetëm askund, pa asgjë. Vinte pluralizmi, fillonte të... u proklamua pluralizmi. Nuk kishte një lëvizje brenda që do të nxirrte diçka tjetër, përveçse lidhje komuniste. Lidhja komuniste degjeneroi, njerëzit... s'funksiononte ma. Njerëzit e panë atë po s'kishin ku t'shkonin, dhe na formua Lidhjen Demokratike. Ishte një azil për njerëzit.

Tani e kemi parasysh se aty u anëtarisun rreth 700 e kusur mijë njerëz. Një eufori kot! Nuk bahen kto gjana me eufori por ja që u bë. Domethanë u futën njerëzit, kërkun azil, se s'kishin ku me shku, s'kishin ku me thy qafën. U braktisën, mbetën jetim, thjeshtë. S'kishin ku t'kapen, jo pse ne dinim aq shumë dhe kishim një program politik t'qartë; nuk kishim një program politik aq t'qartë sa e proklamojnë tani. Programi i Lidhjes Demokratike ishte program i kamuflim me shumë fraza hermetike të cilat nuk deshifroreshin dot sepse duhej me u regjistru atje... Lidhja Demokratike asht' regjistru në Sekretariatit Federativ të Jurisprudencës, atje u regjistru edhe e pranun si të tillë.

Natyrisht, që prapa krejt kësaj, nuk them që ne nuk kishim edhe një djallëzi mrenda. Siç kemi pas gjithmonë n'këtë drejtim. Kemi pas një djallëzi sepse ne shikonim interesin tonë nacional se si mund ta realizojmë. Por, a kishim ide se si do t'a realizojmë atë? Nuk kishim ide, sepse gjërat ishin shumë larg dhe ishin shumë t'komplikuara, tepër larg ishin dhe tepër t'komplikuara ishin. Pastaj vijnë vitet e '90-ta. Lereni ktu që improvizohet pushteti mrenda, e ku e di une qaq bohet... ndodhin një mijë çudira. Une n'atë kohë s'kam qenë ktu, kam qenë n'Shqipëri m'u ka dashtë të iki në Shqipëri, por ke edhe situata kur Bashkësia Kombëtare s'don të marrë vesh fare që ti ekziston. Pavarësisht, se tani themi se jo kështu ku e di une, kemi pa një depërtim; normalisht një depërtim ka ndodhë sepse kishte një interesim për Jugosllavinë n'tanësi se ç'a po ndodhë. Por, për pavarësinë e Kosovës nuk kishte as ide, s'ta miratonte njeri i gjallë. Duhet ta themi haptaz, nuk ta miratonte as miku ma i mirë i politikës n'Evropë, nuk t'a miratonte pavarësinë e Kosovës.

U vegjetu politikisht deri n'momentin kur kjo dhe u lujtë loja e... u improvizu pushteti dhe u bë gjana t'tilla. U bë, u lujtë loja e pushtetit dhe pushtuesit. U bë edhe... të gjitha k'to tash ma njerëzit i dijnë. Por, ka një gjë që mendoj që njerëzit duhet të ju sjellë vëmendje se vitet '90 patën edhe gabime t'mëdha brenda. Shumë gjëra degjenerun sepse u prishën rregullat e lojës, u prish sistemi. Ranë institucionet, ne edhe kur kemi institucione edhe nuk dijnë me funksionu aq mirë, jo ma kur s'kemi institucione fare. Domethanë funksionoi mbi bazën, vendi, njerëzit, shoqëria funksionojnë mbi bazën e një jete kolektive me rregulla t'pashkruara pa detyrime. Kjo ndonjëherë duket sikur asht' në rregull, dikur sikur mundet, por mbi bazat e vullnetit t'mirë nuk bahet shteti. Dhe, Kosova në vitet '90-ta jetonte mbi bazat e vullnetit t'mirë. Mbi bazat e vullnetit t'mirë shkon deri diku pastaj mbetet dhe ashtu mbeten shumë gjëra përgjysëm. Kosovën e viteve '90, shumë gjëra mbeten përgjysëm.

Derisa ndodhi kjo që ajo degjeneroi plotësisht. Une mendoj se deri diku vendimtare kthesë t'rëndësishme n'Kosovë ka qenë viti '95, Marrëveshja e Dejtonit. Aty ka qenë kthesa përfundimtare, kthesa kur zhgënjimi ishte i jashtëzakonshëm. Do t'ju përkujtoj pak, të ia sjellë n'kujtesë edhe njerëzve që e kanë jetu atë kohë.

Ka qënë dimër kur osht' majtë Dejtoni, ftohtë ka qënë. K'tu ka qënë... po ashtu unë s'kam qënë k'tu, kam qënë n'Shqipni. Por, Kosova ka qënë në gjendje *knockdown*, e detronizume plotësisht ka qënë dhe ka qënë e zhgënjyer, e traumatizume, e pafuqishme, e harrume, e lanun n'mëshirën e askujt, e injorume prej Bashkësisë Ndërkombëtare. Kto komisionet e Badinter-it e ktyne... e injorume deri në shkallën e fyerjes. Aq e injorume sa tani atyne nuk iu vjen marre se Badinteri vjen deri k'tu mban ligjerata por une e them haptaz se një prej, njani prej faktorëve që ka ndiku në shtimin e represionit k'tu, ka qënë Badinteri sepse i tha Millosheviçi qikjo osht' e jotja, mbaje se Kosova osht' e jotja... nuk ka asnji ide për ndamjen e saj, e as për ndonjë t'drejtë t'dikujt mbi te.

Bashkësia Ndërkombëtare ka qënë mizore gjatë viteve të '90, nga '95 e mrapa ka qënë mizore, e ashpër në qëndrimet e saj për mos me lanë Kosovën të dalë prej Jugosllavisë, prej Serbisë. Kjo ka vazhdu kështu deri me 1999. Tani të tjerat i dini vetë.

**Kaltrina Krasniqi:** Pse shkutë n'Tiranë?

**Mehmet Kraja:** Kështu ka qënë situata... une shkova, herën e parë shkova vullnetarisht. Shkova me idenë tonë që po bëjmë gjana t'randësishme (buzëqeshë). Qarkullonim ilegalisht me Shqiprinë edhe une pastaj u ktheva. Mas disa mujve vendosa mu kthy, shkova dikund n'fund t'nëntorit edhe vendosa me u kthy në fund t'janarit, vendosa mu kthy n'shkurt. Kur u ktheva, erdhën e m'paralajmrun që po dojnë me m'shti n'burg. Atëhere kishin k'to... ku e di une, komunikonin k'ta avokatët e njerëzit e tjerë, e kishin do lidhje, ende mbanin do lidhje, edhe m'paralajmrun'. Thjeshtë, erdhi dikush i Lidhjes Demokratike, s'po jap emën edhe m'tha që, "N'çast t'zhdukesh prej k'tu se rrezikon t'burgosesh". Isha me grip, domethanë ka qënë shkurti, s'e maj n'mend datën e saktë edhe rruga e vetme ishte me shku n'Preshevë edhe pastaj me kalu kufinin se s'kishim dokumenta valide. Unë andej kisha ardhë, me hy kisha hy, po me dalë s'kisha mundësi. Kisha një letërnjoftim, edhe një letërnjoftim që vlente ende, kishte vlefshmëri. Përmes, me Riza Halimin me qita që jonë n'Preshevë, qita njerëz që sot i kemi atje. Ata na organizun kalimin në Maqedoni, prej Maqedonisë pastaj kisha pasaportë shqiptare dhe ika në Shipni dhe atje pastaj qëndrova deri në '99-tën, shtatë vjet.

**Kaltrina Krasniqi:** Qysh u ndijshit në Shipni?

**Mehmet Kraja:** Unë jam integru mirë në Shipni, por natyrisht si shkrimtar mund t'ju them një gjë, që m'u ka dashtë të rifilloj karrierën si shkrimtar sepse në '86-tën m'është botu ky romani k'tu që e kam botu në '84-shin. Atë që e shkrova në '82-shin, që m'u botu në '84-shin, n'Shipni u ribotu në '86-shin mos gabofsha, dhe u botu në shumë kopje. Edhe nuk isha emën i panjoftun', isha shkrimtar që m'u kishin botu gjana edhe atje. Por, si shkrimtar nuk... shkrimtarët e Kosovës sado që kishin iluzion që funksionojnë atje, jo nuk funksiononin (buzëqeshë). Pra m'u desht' t'ia filloj nga fillimi, t'botoj "Dritat" e ku e di une, të integrohem në ambientin kulturor dhe letrar të Shipnisë dhe une menoj që e kam bo kte për atë periudhë sa kam qëndru atje dhe tani vazhdoj...

Tjetër sa i përket anëve të tjera, une kam jetu'... jam integru' mirë. Domethanë nuk kam pas telashe, kam mbijetu' pa telashe. Nuk përba "histori kosovare" {bën thonjëzat me duar} në atë drejtim, se historitë kosovare me Shqipërinë janë t'ngatërrume, po historia jeme osht' e thjeshtë, mendoj në raport me Shqipërinë (buzëqeshë).

**Jeta Profesionale**

*[Pjesë e prerë nga video-intervista: intervistuesja e pyet të intervistuarën për jetën e saj profesionale dhe karrierën.]*

**Mehmet Kraja:** Kjo, sa i përket anës biografike domethanë deri kur filloj punën gazetar në Rilindje. Pastaj iu kom përkushtu' Rilindjes. Gjithmonë e kam pas si ide, natyrisht kam fillu' t'shkruj. Librin e parë e kam botu' në '78-tën.

**Kaltrina Krasniqi:** Sigurisht keni fillu' t'shkruni ma heret.

**Mehmet Kraja:** Po, normalisht si gjimnazist po. T'i kallxoj një detaj për gjimnaz, kam fillu'... Shkrimi asht' një histori tjetër t'cilën duhet me pak... si e veçantë, por kjo nga ana jetësore duhet t'them që tani t'u marrë parasysh që letërsia nuk... të gjithë e dinim se letërsia k'tu nuk t'krijon mundësi për t'mbajtë veten, për t'ekzistë, atëherë duhej t'mbahej një profesion. Gjithmonë gazetarinë e kemi pas ma t'afërt, edhe kryesisht shumica e shkrimtarëve punojnë punë nëpër gazeta ose punë gazetarie, ose punë rreth gazetave, ndonjëherë shpi botuese pra kjo ishte puna që kryesisht e banim shkrimtarët.

Dhe unë u përfshiva në punë gazetarie në Rilindje. Kam punu deri sa â mbyllë Rilindja, deri në ditën kur është mbyllë Rilindja kom qenë n'Rilindje. Njëzet e kusur vjet gazetari kam, diku punë gazetarie kam pas nja 33 vjet punë deri sa e kam lanë gazetarinë. Pra, është një profesion të cilin e kemi ushtru, të cilin e kam ushtru në dy kohë të ndryshme. Mund ta them dy ose tri kohë të ndryshme. E kam ushtru në kohën e socializmit, e kam ushtru në kohën... periudhën e rrëmujës e quj unë, s'ka qenë as socializëm, as komunizëm, as liri as kurgjo – kanë qenë vitet e '90-ta që kanë qenë një kohë pa kohë, s'di ç'a kanë qenë. S'mund t'i quj, s'di as vet ç'a kanë qenë dhe kam ardhë në periudhën mas luftës, kam vazhdu me gazetarinë. Pra nja 30 e kusur vjet kam ba punë gazetarie, ndonjëherë si gazetar aktiv, pastaj një kohë si kolumnist, pastaj si redaktor, pastaj... domethanë kryesisht punë që bahen zakonisht në gazetar. Kjo sa i përket anës t'profesionit me t'cilin jam marrë, se gjithmonë t'u e lanë me një anë punën, përkushtimin individual për shkakun personal që e kam pas – letërsinë.

Me letërsi, kam fillu' t'shkruj si gjimnazist, kam fillu' t'botoj. Si fillorist shkruj, domethanë diçka që s'e kisha idenë se si bahet letërsia (buzëqeshë). Kisha një fletore që shkruaja. Kur kam qenë gjimnazist kam botu' tregimet e para n'jetë teme t're. Tregimin e parë e kam qu' redaksisë së "Jetës së Re", pa dy pa njo e kam shtypë n'makinë me mjaft probleme. Qe një tregim goxha i gjatë, edhe i'a kom çu "Jetës së Re". Kryeredaktor ka qenë Esad Mekuli.

Kur e kam marrë mas një kohe, ka qenë dikun pranverë, një punë, pastaj ka ardhë koha e pushimeve dhe unë n'kohën e pushimeve kom shku n'Krajë n'katund. N'katund atje s'kishim asgja. Kur vjen një... domethanë komunikimi ishte i vështirë edhe i pamundun gati. Vjen njani prej atyne, ka qenë Ibrahim Berijashi që botonte, kishte botu e kishte njoftë qe k'tu {bën me gisht nga dritarja} nxanës dhe studentë në Kosovë dhe ishte taku'... jo i kishte shkru' telegraf Esadi [Mekuli], "M'trego kush është ky Mehmet Kraja. A është pseudonim, apo kush është se po du me ia botu tregimin?" Ky i tregon, i shkrun telegraf ose i shkrun letër, nuk e di, dhe i tregon. Domethanë që aty fillon historia e botimit dhe e njohjes pastaj me Esadin kur kom marrë punën e parë kur kam ardhë n'Prishtinë n'71-shin. Edhe ai m'vendosë n'konvikt edhe menjëherë punën e parë pas saj e kam ba që kom shku', jom taku' me Esad Mekulin. M'ka pritë në mënyrë të jashtëzakonshme, diçka që nuk besoj që ka sot ndonji redaktor nga këto që i njohim që e pret dikënd ashtu. Esadi ka qenë i jashtëzakonshëm n'atë drejtim. M'ka pritë në mënyrë të jashtëzakonshme edhe që aty masnej fillon bashkëpunimi me Jetën e Re, pothuajse disa vjet pa ndërpreme.

Natyrisht, paralelisht me punën si gazetar, asht' dashtë t'rujsh një kohë të mjaftushme t'sakrifikosh një kohë për punën e letërsisë. Na s'kemi jetu... askush n'Kosovë s'ka jetu me punën e letërsisë. Nuk arrijmë t'jetojmë

me te. Domethanë, s'besoj që ka pas dikush që mund t'jetojë me letërsi. Nuk kemi mujtë t'jetojmë me punën që kemi bo n'fushën e letërsisë. Kemi bo gjithmonë një punë sekondare, një punë t'dytë dhe pastaj i jemi përkushtu ksaj.

Kam botu vit pas viti, deri tani janë diku 25 libra. Kryesisht janë 11 ose 12 romane, ndër to tregime, drama, kom shkru edhe libra publicistikë – tre-katër libra publicistikë. Edhe natyrisht kom shkru tekste, me qindra, me mijëra tekste publicistike nëpër gazeta.

**Kaltrina Krasniqi:** Nji digresion i vogël, ky tregimi..... për çka osht'?

**Mehmet Kraja:** Për ambientin tonë atje, për zhvillimet... domethanë ishte një tregim pak etnografik, sipas një rrëfimi t'vjetër për ku di unë. Një gja t'vjetër që tash nuk e mbaj në mend. Po, ishte një rrëfim për ambientin, për vendin dhe për kohën atje, domethanë diçka e tillë. Nuk ishte se ishte diçka e madhe natyrisht, isha i ri n'atë kohë, s'besoj që kom ditë me shkru' noj gja, po ja që atij i kishte ba përshtypje dhe u botun një pas një disa... botova disa tregime t'cilat pastaj i kam përbledhë në një libër t'veçantë.

K'tu ka një gja, duhet t'a kemi parasysh, se ne formimin e kemi pasë si shkrimtarë, e kemi pas të vështirë. K'tu të gjithë shkrimtarët në Kosovë formimin e kanë pas të vështirë. Jemi gjetë në situata shumë konfuze. Ky konfuzitet të cilin ju tash do ta shihni vetë, që ju thash më përpara, jo nacionalizëm, jo...

Në Jugosllavi kemi qenë t'libër në kuptimin e sjelljes së metodës së shkrimit, së metodës letrare sepse qysh me 1957-tën Tito me Kërlezhën proklamojnë pluralizmin e metodave edhe nuk shkante mo njeri n'burg për letërsi. Për letërsi nuk shkoshe mo n'burg n'Jugosllavi. Kishte mënyra për ta kontrollu, kishte mënyra për ta kontrollu, ajo ishte përmes instrumenteve, sepse gjithkunj ne diku ishim domethanë, dhe përmes asaj forme kontrollohej. Por k'tu nuk ka qenë problemi te, ne nuk kemi qenë e as nuk kemi synu të bahemi ndoshta aty ktu sepse s'kemi pas... s'ka pasë nevojë të jemi dicidentë ideologjikë. Si t'baheshe disident ideologjik kur ti mundesh me shkru si Ionesko ose sikur Becketi, drama e Becketit "Në Pritje të Godosë" vihet në Paris me '67-tën, ose me '68-tën, me '69-shën vjen n'Prishtinë. Domethanë me '69-shin asht' vu n'skenë n'Prishtinë... s'ke shancë të bahesh dicidentë ideologjik n'atë rrethanë. Dhe kte, duhet t'hiqet nga ato... kemi pas dicidencë ideologjike n'Kosovë ose n'Jugosllavi – jo! Sepse, Tito u mori argumentin nga dora e proklamoi pluralizmin e metodave letrare dhe metodave dhe të gjitha metodave. Natyrisht, i favorizonin ata që shkrunin... domethanë që aplikonin metodat e socializmit, realizmit e ku ta di unë, ose metodat marksiste. Ato ishin të favorizuarat e pushtetit, po lirinë e kishin të gjithë.

Por, kishte një gja tjetër, filloi gradualisht të zhvillohet disidencja nacionale dhe kjo ishte ajo t'cilën pushteti e luftonte. Prandaj në Kosovë u formu edhe u kriju edhe u zhvillu një letërsi e tanë me metaforë, me t'folunin metaforik. Me rrëfimin me kuptim t'bartun. U zhvillu një letërsi e cila tjetër fliste dhe tjetër nënkuptonte. Ç'është kuptimi i metaforës, është ky, pra ndryshe flet dhe ndryshe duhesh ta kuptosh. U ba një letërsi e tanë për t'fshehë disidencën nacionale. Kushtimisht po them për t'fshehë dhe për... sepse në metaforë nuk kapeshe dot. Megjithatë kishte një polici metaforash, të themi kështu, që i hulmonte ato dhe u bonte vërejtje shkrimtarëve edhe për metafora. Ato kulla, ato kështjella, ajo... "E di një fjalë prej guri" thonte Azem Shkreli. Ky guri ç'është ky guri, pse ky guri kaq shumë përdoret? Pse kullat janë aq shumë të pranishme në poezinë e shkrimtarëve të Kosovës?

Pra u kriju një letërsi e tanë, u ba një letërsi e tanë që kishte gjuhën e metaforës. Përdorej për shkak të fshehjes së disidencës. Edhe në prozë, unë kom qenë poet, unë jam prozator, edhe n'prozë ne merrshim me tema historike, me tema... unë dy-tre romanet e para i kam me tema jashtëzakonisht të largëta të cilat synonin gjithmonë të... Maj n'mend shumë mirë, kom pas banesën në Kodër t'Dillit, ishte ora policore në '82-shin, ishte orë policore mas demonstratave. Zgjati shumë kohë, orë policore u zgjatën, u përsëritën

disa herë, herë pas here me rastin e përvjetorit të demonstratave m' duket u ba një forcë policore përsëri, po m' duket që ka qenë në '82-shin jo në '81-shin, kur kam shkru romanin "Udhëzime për kapërcimin e detit" dhe ka t'boj me Mesjetën. Unë e projektoja, dhe e di që nga dritarja në t'cilën unë shkruaja natën, e shihja policinë e cila e kishte zanë një udhëkryq dhe rrinte e kontrollonte. Natyrisht policia me pajisjet e njësisve speciale që i runte, ndalonte qarkullimin, nuk kishte lëvizje n'atë kohë. Nuk duhej t'kishte, mund t'vriteshe gjithkush që dilte prej banesave. Dhe unë e shihja tanë kohën ata policë se si rrinin në udhëkryq dhe shkruja "Udhëzime për kapërcimin..." që kishte tematikë Mesjetën.

Pra, para sysh e kisha policinë dhe këndeje e kisha një tematikë që shkrunte për Mesjetën. Pra, ne u msum' të flitnim me aluzione dhe të flitnim me metafora. Kjo ishte një... u kriju një letërsi që flite në mënyrë të tërthortë me metafora dhe kjo ishte për t'fshehtë disidencën nacionale. Por ne patëm nga një problem tashti, kjo ishte ajo që thamë se formimi letrar i yni ka qenë me shumë telashe. Didenca jonë, knej kishim letërsinë e realizmit socialist me t'cilën ushqeheshim vazhdimisht nga Shqipëria, letërsia shqipe pothuajse kishte rilindjen kombëtare, letërsinë e rilindjes, kishte edhe letërsinë e realizmit socialist që vinte nga Shqipëria. Nga Kosova kishte, për shembull në prozë kishte një numër tregimesh, tre romane t'parëndësishëm, ose t'rëndësishëm, s'ka rëndësi, por një traditë t'vogël letrare, s'kishte një letërsi, ishte një letërsi që mund t'a lexoje për një javë, dy, edhe u kry muhabeti. Pastaj ça me bo?

Kjo ishte letërsia me t'cilën ti duhej t'formoheshe. Dhe çfarë ne bamë tani? Na ishim në presionin e vazhdushëm, t'letërsisë nga Shqipëria që ishte e kufizume, por kishte brenda romantizmin nacional dhe kishte dogmën socialiste normalisht – dy gjana i kishte brenda. Sepse Enver Hoxha bani një simbiozë, të romantizmit nacional dhe ideologjisë komuniste, i bani k'to, i shartoi mirë, edhe i pakatoi bukur për me na i dhanë neve. Mrena nuk e hanin shqiptarët, mrena Shqipnisë ishte shumë vështirë ta gëlltitnin këtë pako të bukur. Neve, k'nej përtej kufinit e gëlltitën kollaj këtë. Domethanë ne ishin nën trysninë e vazhdushme të këtij realizmi socialist dhe të kësaj ideologjie nacional romantizmi shqiptar dhe ishin nën trysninë e pamundësisë që t'ofron ajo. Ne e shihnim atë letërsi, që ajo metodë e realizmit socialist neve s'na pëlqente dhe knej kishim nga Jugosllavia, kishim mundësi të jashtëzakonshme të komunikimit thashë me letërsinë evropiane, letërsi botnore.

Une e thashë që kam kompletet, deri sa në Shipni në atë kohë nuk lexoheshin dhe nuk lejoheshin as Dostojevski, as Kafka, as Prusti, as Xhojsin, as... pra një letërsi e tanë. Ne këndeje furnizoheshim me letërsi pikerisht të këtyllë. N'anën tjetër... sepse Jugosllavia tashmo kishte proklamuar hapin ndaj rrymimeve të ndryshme letrare artistike dhe ndaj ndikimeve të perëndimit. Edhe bile, bile ishte n'modë me qenë sa ma afër. Ndonjëherë kishte shumë epigonizëm n'këtë punë. Kishte epigonizëm edhe kishte plagjiatura t' thjeshta n'lidhje me perëndimin. Epigonizëm kishte shumë.

Tani letërsia e Kosovës u gjet' në këtë trysni t'dyanshme. Nuk kishte shumë qartësi në këtë drejtim, a të orientohej. Një pjesë e shkrimtarëve u banë soc-realistë siç ishin shkrimtarët e Shqipnisë. Dikush u ba modernist, sikur ishte... modelet siç ishin, ku e di une, modelet e përmenda Beketin, e përmenda tjetër... Pra, knej ultramodernë, knej një soc-realizëm gati primitiv. Midis k'tyne dy kundërshtive, ne u gjetëm shumë keq dhe ne kishim një problem të cilin nuk e hetum, por u pa ma vonë kjo. Kujt i'a lamë lexusit? Çka u ba me lexusin?

Në t'vërtetë ne na pëlqente të ishim modern edhe u shkrun drama siç ishte ajo e Beketit. U banë edhe romane siç ishin ku e di une, ndonjë e Xhojsit ose dikujt tjetër... u banë sipas modeleve t'perëndimit, ose anti-roman. U shkru anti-roman si Natali... ku e di une. Por, kishte problem një gjë, se lexusin na e rrëmbeu letërsia soc-realiste e Shqipërisë sepse konstalacioni dituror dhe niveli dituror por edhe gjendja shpirtnore e lexusit të Kosovës t'asaj kohe, korrespondonte dhe komunikonte ma lehtë me letërsinë e



realizmit socialist e cila kishte “realizëm socialist” {bën thonjëzat me duar} dhe nacional-romantizëm brenda që vinte nga Shqipëria, se sa me loneskon ose Beketin ose anti-romane.

Kishte një shpërpjesëtim kësisoji, afër Teatrit t’Prishtinës kalonte përrocka e qelbur, dhe brenda në Teatër vihej Beketi. Ky ishte një shpërpjesëtim të cilën ne e jetum. Sot, po e shikove nga kjo distancë, duket sikur e parodizime por ne e jetum këte. N’anën tjetër Prishtina mendohej t’bante një jetë kulturore, u përpoq t’bante një jetë kulturore. Ajo jetë kulturore e Prishtinës natyrisht që ishte një imitacion, imitonte qarqet tjera kulturore në Jugosllavi, nuk diskutohet ajo, kështu ishte.

U kriju edhe një elitë po ashtu nga modelet jo shumë Beogradi apo Zagrebi, se Beogradi ishin larg, Zagrebi ishin larg, por si Sarajeva, Shkupi. U krijuan do modele të tilla që domethanë, t’kishte një elitë t’veten. Por ajo elitë shpesh ishte me mungesa t’mëdha edhe në numër. Kur shkoje në teatër i shihje po ata njerëz, kur shkoje n’ekspozitë i shihje po ata njerëz, edhe numerikisht mungojshin njerëzit. Kishte pak... Domethanë shkojshe n’teatër i shihshe po ata njerëz, shkoshe n’ekspozitë i shihje po ata njerëz. Shkoje në një koncert t’orkestrës i shihje po ata njerëz, domethanë se numri i t’emancipuarve në pamje letrare artistike ishte shumë i kufizuar.

N’anën tjetër shënohej që le t’bajmë një art tonin. T’i japim frymë, hapësinë dhe t’i bajmë një art tonin. Ishte pak iluzore, kishte edhe qëllime brenda, kishte edhe qëllime politike normal. Normalisht, sepse n’atë kohë u synu le t’themi haptas, që u synu që shqiptarët në Jugosllavi të krijojnë identitetin e tyre të ndryshëm nga identiteti i shqiptarëve të Shqipërisë. Pra idea ishte që të krijohen shqiptarët e Kosovës, kanë komb jugosllav. Dhe mbase mund të krijoheshin sikur mos t’bahej një gabim. Gabimin e bani Serbia, sepse pas ‘81-shit insistoi që t’krijojë nga shqiptarët e Kosovës, t’baheshin serb. T’i bajë serbë shqiptarët, nuk baheshin, serbë nuk baheshin. Jugosllavë shqiptarët fillun të baheshin. Ose nisën t’baheshin ose kishte elemente që mund t’baheshin; ose s’paku kishte të tillë që e fillun ka pak, ka pak të integroheshin. Nëse jo komb jugosllav në kuptimin e thjeshtë t’fjalës, po kishte të tillë që fillun të integroheshin. Dhe u kriju një shtresë kulturore, u kriju edhe një letërsi edhe u kriju edhe një numër... edhe muzikë edhe... domethanë u krijuan të gjitha artet, edhe një teatër.

Por, t’jemi t’saktë në një gjë, kjo ishte në shumicën e rasteve ishte letërsi jugosllave, muzikë jugosllave, art figurativ jugosllav me predispozita të këtilla që brenda Jugosllavisë t’funktiononte. A u rebelum ne? A ishim të tillë si na donin? Jo, nuk ishim normalisht sepse ne kishim disidencën nacionale. Kjo filloi gradualisht, pra disidencë nacionale ka fillu në Kosovë atëherë kur filloi liria, vetëdija dhe liria. Nji vetëdije minimale domethonë dhe një liri minimale, ajo u shfrytëzua për të kriju’ disidencën nacionale e cila prodhoi një pas një zhvillimet deri te kjo që kemi sot. Kështu i shoh une gjanat.

Do t’shkoj kronologjikisht. Vitet e ‘70-ta disi përputhet me moshën teme. Kom qenë i ri, domethonë moshë student dhe periudhën kur ju thashë në Botën e Re kur na qitën. Pra kishim durim, kurajo dhe entuziazëm përballë. Kishte një eufori nacionale natyrisht. E maj n’mend kur n’78-shin kam qenë gazetar, kam përcjellë krejt manifestimet që janë mbajtë me rastin e 100 vjetorit të Lidhjes së Prizrenit. Është shënu 100 vjetori i Lidhjes së Prizrenit, është shënu n’Shqipni, po është shënu edhe knej, paralelisht është shënu; edhe këndej është shënu mjaft mirë shumë se i dha rëndësi vetë shteti. Sepse ishte ajo idea që nga këta shqiptarë ne do të bëjmë një komb në vete. T’ju them se edhe n’gjuhë ka pasë probleme të tilla, domethanë ka pasë iniciativa të tilla.

Në këto vitet ‘70, domethanë unë i kom kalu si t’gjithë të rinjtë dhe me një lloj entuziazmi. Me një lloj ideje se k’tu mund të bahet diçka. Se ne mund të bahemi si t’bahemi, se ashtu siç jemi, po mund të bahemi disi. Edhe po, kishim një vetëbesim mund ta quj. Vitet e ‘80-ta ishin vitet ma degulizonuse për neve. Ata që kishin iluzion se do t’bahej, se do t’mund të integroheshin në Jugosllavi, ata marun. S’kish kurgjo mo



sepse u prishën edhe kuronat, kishe kunorë kishe njerëz t'martum me serbe ose t'kundërt por shumica ishin... u prishën kunorat. T'jemi real n'këtë pikë, shkoi deri aty konflikti sa nuk ishte mendu se ishte aq i thellë konflikti. Ishte mendu se ishin rrafshu mendimet shumë, por në '81-shin nxorri në sipërfaqe një katastrofë, marrëdhëniet ndër-nacionale dhe iluzionet e njerëzve. S'kishte mo iluzione për asgja. N'anën tjetër shqiptarët në Jugosllavi mo nuk kishte besim kërkush te shqiptarët në Jugosllavi. Dhe nuk kishte mo vetëm serbët, por sot flasin ndryshe natyrisht. Ishin edhe kroatët, ishin serbët edhe sllovenët edhe boshnjakët edhe maqedonët që e kthyn urrejtjen ndaj shqiptarëve... natyrisht serbët prinin në atë punë, por të gjithë ishin korifej. Korifej ishin serbët, por antarë për bazë të atij kori ishin të gjithë, pa përjashtim.

Ishte një urrejtje ndaj shqiptarëve që e çoj krejt Jugosllavinë n'kamë, pa përjashtim. Tani thonë jo malazetë kanë qenë ma ndryshe... jo... të gjithë pa përjashtim kishin një qëndrim. Pra, shkatërroi iluzionet e njerëzve. Veçmas atyne shqiptarëve të cilët mendun se mund të integroheshin në Jugosllavi. Në anë tjetër, shkëputi lidhjet me Shqipërinë - lidhjet kulturore me Shqipërinë. U shkëput një damar i cili kishte, ishte jetëdhënëse për shqiptarët e Kosovës e shqiptarët në Jugosllavi sepse k'tu filloi detronizimi dhe shkatërrimi i institucioneve respektivisht sllavizimi i tyne. N'mënyrë të jashtëzakonshme, të shpejtë, të rrufeshme dhe pas asnjë alternativë. Shtetëzimi, sllavizimi, kontrolli mbi te, dhe në anën tjetër këputja me Shqipërinë. Këputja e atij damari jetëdhënëse, ishin vitet ma t'vështira, une i shoh si vitet ma... deri sa vitet të '90-ta janë vitet kaotike të cilat as ne s'dijmë si t'i qujmë. Vitet '80 ishin vite shumë të vështira. Në këtë pikëpamje domethanë ne ishim... komplet mbetëm të strukun në një qoshe, k'ta thonin politikanët, "Bira e minit, 300 herë s'e gjen" [e pakupt.] kjo ishte domethanë të nejnë në trysni të madhe, nën trysninë e urrejtjes, nën trysninë politike, nën trysninë e burgosjes, nën trysninë ideologjike, ishte një mungesë totale e prespektivës. Në një pikëpamje kjo bani mirë, shkatërroi iluzionet, s'kishte ma iluzione se mund t'bahet gjë ma me këtë vend dhe këtë shtet.

Detyrimisht duhet t'kërkoje prespektivë tjetër, për k'ta njerëz duhej t'kërkoje prespektivë tjetër. Detyrimisht duhet t'orientoheshe... s'kishte kah tjetër, do t'orientoheshe kah identiteti yt dhe integriteti kombëtar, s'kishte alternativë tjetër. Komunizmi s'ishte i randësishëm, ideologjia s'kishte pikë randësije. Tani i japin randësi se ka qenë komunizmi, ka qenë komunizëm, komunizmi që nga... tu marrë parasysh periudhat që nga koha e liberalizmit viteve t'70-ta e prapa s'paraqet mo gjë komunizmi. Çështja nacionale ishte çështje parësore dhe kjo çështje nacionale filloi gradualisht të rekrutojë njerëz. Në pikëpamje kishte dy forma, rekrutonte njerëz dhe i afronte me Shqipëri e cila u refuzo, u kputën lidhjet. Njerëzit, kur flite [fliste] Enver Hoxha, kur mbajti Kongresin e Partisë menjëherë pas '81-shit njerëzit shkun në Gjakovë, gjysa e Prishtinës u dyndë n'Gjakovë për me marrë, se i merrke Televizioni Shqiptar atje. Nuk ishte se i kish' marrë malli për Enver Hoxhën, donin të dinin se çfarë po ndodhë, çfarë qëndrimi po mban Shqipëria në Kongres t'Partisë, çfarë qëndrimi po mban Shqipëria ndaj Kosovës, k'tu ishte problemi.

Vitet '80 ishin të këtilla, ishin shumë të randa edhe shumë vështirë edhe por njëkohësisht edhe mobilizuse sepse pastrun gjanat, diferencun gjanat shumë qartë. Në një anë ishte... po kishte edhe një gjë duhet t'them edhe midis... çdo gjë shqiptare u ba e mirë, kjo ishte ajo ana qesharake e k'saj shtate, jo vetëm qesharake por edhe e damshme natyrisht. Sepse, u ba një lloj unifikimi i paqëndrueshëm sepse nuk u diferencun vlerat. Homogjenizimi kaloi shkallën normale të një vendi normal e t'njerëzve normalë. Të gjithë njerëzit, të gjithë shqiptarët nuk mund t'jetë mirë.

Është problemi te homogjenizimi, të gjithë shqiptarët u banë. Në një anë ishte pushteti me ato diferencimet e famshme edhe me instrumentet e tij që midis tyre natyrisht nuk viheshin... mund t'qëndronin serbët prapa k'tyre, por punët kryesore i kryenin vetë shqiptarët mrenda institucioneve. Diferencimin e banë vetë shqiptarët, ata ndërmorrën veprime të cilat ishin bizarre, ishin të ulta. Natyrisht ishin gjana që... gjanat ishin të pastra, por n'anën tjetër nuk kishin të pastra në një anë tjetër në

homogjenizimin e shqiptarëve. N'atë moment mund edhe të ishte e nevojshme sepse banin frontin e përbashkët, të gjithë... çdo gja shqiptare ishte e mirë. Të gjithë ishin t'mirë në atë moment, që është joreale natyrisht por kështu ishte. Pra u ba një homogjenizim i madh i popullsisë.

Dhe tashi, k'ta njerëz, u pa që ky homogjenizim dhe kjo kundërthënie e ashpër midis shtetit dhe një pjese t'madhe të popullsisë dhe midis bartësve të pushtetit në Kosovë dhe popullsisë po ashtu, krijoi çamje t'mëdha, dhe drama t'mëdha edhe brenda familjeve. Kishte familje brenda n'diferencim, kishte probleme me familjarë, djali kundër babës, ka pas raste kësisoji. I kanë leqitë në njifar forme njerëzit t'cilët kanë qenë të afërt me pushtetin, fillun t'i urrejnë publikisht. Pra, u ba një front i përgjithshëm, një unifikim knej dhe homogjenizim kombëtar në një anë, dhe në anën tjetër u diferencun shumë qartë ata që ishin me anën tjetër. Edhe u ashpërsu situata, mjaft ashpër, edhe dihej që kjo situatë nuk mund të shkonte gjatë.

Shkoi deri ka fundi i viteve të '80-ta. Fundi i viteve të '80-ta pastaj fillun ato që tashma i dijmë.

**Kaltrina Krasniqi:** Ju keni shkru gjatë viteve të '80 gjithashtu. Për çka shkrujshit?

**Mehmet Kraja:** T'viteve '80 thash kam shkru romanin që ta përmenda, e shihja policinë e shkruja roman për Mesjetën. Kam vazhdu t'shkruj normalisht, kam shkru drama, kam shkru dramën "Hana prej letre" e cila megjithëse u shpërbly në konkursin "Katerina Josipi" nuk u vendos k'tu sepse bënte fjalë për demonstratën diçka... krijonte një aluzion të tillë. Pra thashë gjithnji flas, ne flitnim me metafora dhe kishte një të tillë. Domethanë ishte kryesisht letërsi në funksion të saj, po natyrisht kishim edhe publicistikën paralelisht me këtë. N'atë kohë publicistikë nuk mund t'them se kemi ba... po ka fundi i viteve të 80-të, po pastaj fillon gjallërimi, mu gjallëru situata dhe fillun të shprehen publikisht atë. Pakënaqësi, nuk shprehëm ndonjë gja, por gjithnji një qëndrueshmëri ma t'madhe nacionale dhe një pakënaqësi me rendin e gjanave. Kjo ishte fillimi i kësaj, do t'thotë fillimi i lëvizjeve politike të fundi i viteve... sepse vitet '90-të kanë një para-rendje, dhe ajo është qëkjo që ju thashë. Është periudhë shumë e ashpër e represionit në vitet '80-të dhe domethanë shpërbamje e sistemit, n'fund t'viteve '80-të, jo n'fillim t'viteve '90-të, po n'fund t'viteve '80-të. N'fund t'viteve t'80-të filloi shpërbamja realisht.

## Ëndrrat

*[Pjesë e prerë nga video-intervista: intervistuesja e pyet të intervistuarën se cilat ishin ëndrrat e tij.]*

Nuk menoj asnjëherë për atë se jeta nuk osht' konkurs, s'është... jeta është proces normal. Unë e shikoj jetën normale, nuk i ve kushte. Kurrë vetes s'i kam vnu as s'i kam vnu caqe domethanë. Kam bo atë që kam ditë me bo edhe kam bo atë që kam mujtë me bo, edhe e kam ba atë që mas miri di me ba, unë jam shkrimtar. N'esencë jam shkrimtar dhe une k'to observime, e di që ndonjëherë nuk i qëndrojnë kritikës shkencore që do t'thoshte dikush. Nuk i qëndrojnë kritikës shkencore, po mu nuk ma nin për atë punë që s'i qëndrojnë kritikës shkencore se unë jam shkrimtar. Shkrimtari si i tillë, unë pavarësisht se bëj jetë t'rregullt, pavarësisht se bëj punë t'rregullt ose përpiqem t'bëj punë t'rregullt, t'sillem si qytetar lojal si qytetar i rregullt; megjithatë, unë jam shkrimtar. Dhe, në mendime nuk mund t'i vë vetes kufizime të tilla ose nevoja për t'kapërcy ku e di une, ku e di une veten. Une kam ambiciet e mija, nuk i fshehi aspak ato, por ato ambicie përpiqem që t'jenë reale dhe përpiqem që të më sillen ndaj vetes sikur t'jetë ai dikush tjetër.

Domethanë unë them, "Po, unë jam ky", nuk m'vjen keq që jam ky që jam. Mbase kështu e kam pas fatin që t'jem ky që jam. Nuk kam ndonji pretendim n'këtë drejtim. Nuk m'bahet vonë se a asht' mirë kështu, apo s'asht mirë. Vazhdoj kështu siç jam, nuk m'ka mbetë ndonji peng.